



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura III

Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale
Mbledhja nr. 16
Prishtinë, 08 korrik 2008, ora 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225

PROCESVERBAL

i mbledhjes së Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale

Në mbledhje morën pjesë: Sadik Idriz, Rita Hajzeraj, Flora Brovina, Nurishahe Hulaj, Gjylnaze Sylja, Mimoza Ahmetaj, Bujar Bukoshi, Qamile Morina, Armend Zemaj dhe Teuta Hadri.

Mungoi: Slllobodan Petroviq.

Të pranishëm:

Nga Zyra e Komisioneve të Kuvendit: Shpresa Haxhijaj-administratore, Drita Morina – zyrtare e lartë ligjore, Fatime Qorri - zyrtare ligjore dhe Mirjeta Heta- nëpunëse administrative.

Nga USAID: Haxhi Gashi

Nga NDI: Shefki Kastrati

Nga zyra e Presidentit të Kosovës: Nexhat Shatri.

Mbledhjen e kryesoi z. Sadik Idriz, kryetar i Komisionit.

Komisioni i zhvilloi punimet me këtë

REND DITE

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar ;
3. Miratimi i procesverbalit nga dëgjimi publik për Projektligjin për punën;
4. Shqyrtimi i Projektligjit për punë;
5. Të ndryshme.

Kryesuesi- Konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e mbledhjes dhe e hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar

Kryesuesi-Konstatoi se Komisioni e miratoi procesverbalin e mbledhjes së kaluar pa vërejtje.

3. Miratimi i procesverbalit nga dëgjimi publik për Projektligjin për Punën

Gjylnaze Syla – Tha se me qëllim që mbarëvajtja e dëgjimeve publike në të ardhmen të jetë më e mirë, ajo tha se ka një vërejtje sa i përket rrjedhës së dëgjimit publik të mbajtur me datë 25 qershor 2008. Sipas saj, së pari duhet të marrin fjalën anëtarët e Komisionit e pastaj pjesëmarrësit e tjerë në dëgjim publik, sepse anëtarët e Komisionit janë ata që marrin informata të nevojshme për Ligjin për të cilin është organizuar dëgjimi.

Teuta Hadri- Tha se dëgjimi publik u organizua më qëllim të zgjidhjes së dilemave që Komisioni i ka pasur lidhur me këtë projektligj, por megjithatë Komisioni nuk mori asnjë ndihmë më të madhe ose ndonjë informacion më tepër se që ka pasur para dëgjimit publik.

Kryesuesi- Konstatoi se procesverbali nga dëgjimi publik për Projektligjin për punën u miratua pa vërejtje.

4. Shqyrtimi i Projektligjit për punën

Sadik Idriz- I njoftoi anëtarët e Komisionit, se Qeveria e ka kërkuar tërheqjen nga shqyrtimi të projektligjit për punë dhe Ligjit për sigurimet shëndetësore. Këtë kërkesë e ka shqyrtuar edhe Kryesia e Kuvendit që ka kërkuar nga Komisioni t'i paraqesë Kuvendit rekomandim në bazë të kërkesës së Qeverisë. Hapi diskutimin për këtë pikë të rendit të ditës.

Gjylnaze Syla-Tha se personalisht ajo është për kthimin e Ligjit në ripunim në Qeveri, për arsye që Komisioni i ka diskutuar në dëgjimin publik. Komisioni ka punuar në këtë projektligj dhe duhet ta ketë qëndrimin e vet lidhur me të. Ajo ishte e mendimit se Komisioni nuk duhet ta mbështesë kërkesën e Qeverisë për arsye shumë praktike-duhet të respektohet procedura . Meqenëse Ligji e ka kaluar leximin e parë, sipas Rregullores së punës së Kuvendit të Kosovës, sponsoruesi mund ta tërheqë Projektligjin gjatë shqyrtimit të parë deri para fillimit të procedurës së votimit në parim. Komisioni duhet t'i rekomandojë Qeverisë që në seancë gojarisht ta kërkojë tërheqjen e Ligjit si dhe të kërkojë nga Qeveria brenda një afatit të caktuar kohor ta procedojë këtë Ligj, sepse është ligj bazik.

Armend Zemaj- Tha se sipas Rregullores së punës së Kuvendit, sponsoruesi ka të drejtë ta tërheqë projektligjin. Komisioni mund ta japë një rekomandim se çka duhet të bëhet më tutje, ndërsa sponsoruesi deri në leximin e dytë ka të drejtë ta tërheqë Ligjin. Ky ligj për këtë vit nuk ka mundësi të ri- procedohet, sepse ka implikime të mëdha buxhetore që nuk janë paraparë.

Teuta Hadri- Tha se e mbështet mendimin e deputetit Armend Zemaj. Komisioni ka kërkuar ndihmë nga Qeveria se si të veprohet me këtë projektligj dhe tani Qeveria e ka kërkuar tërheqjen e

Ligjit për ripunim. Ajo ishte e mendimit të mbështetëj kërkesa e Qeverisë për tërheqjen e projektligjit.

Mimoza Ahmetaj– Tha se Komisioni ende nuk ka arritur të ndonjë rekomandim konkret për këtë projektligj, sepse Komisioni është në fazën e konsultimeve të organizmave të ndryshëm lidhur me këtë ligj. Ajo ishte e mendimit që të përkrahet kërkesa e Qeverisë. Sa i përket Ligjit për sigurimet shëndetësore, tha se përderisa nuk ekziston fondi për sigurime shëndetësore, e kotë është të bëhet Ligji për sigurimet shëndetësore.

Qamile Morina- Të pranohet ose jo kërkesa e Qeverisë, e konsideron akt të kryer, pasi edhe Kryesia e Kuvendit ka vendosur një gjë të tillë. Por ajo që është shqetësuese për të është se për gjashtë muaj për të gjitha ligjet për të cilat ka punuar ky Komision kanë mbetur të papërfunduara. Ligji për sigurime shëndetësore në vitin 2006 është kthyer nga PSSP- ja për tu bërë ekspertiza e mirë. Ligjet që po procedohen në Kuvend nuk po kanë ekspertizë të mjaftueshme duke marrë parasysh që edhe brenda Kuvendit nuk ka ekspertë që mund t'i bëjnë ata sa më efektivë.

Flora Borvina-Tha se Qeveria ka të drejtën për tërheqje të ligjit gjatë gjithë kohës. Ajo tha se puna e Komisionit e bërë deri më tani për këto ligje nuk është e kotë, mbasi kjo do të shërbejë për sponzoruesin si informatë për ripunim të këtyre ligjeve. Komisioni duhet ta pranojë kërkesën për tërheqje të këtyre ligjeve, por me vërejtjen që sa më parë të ri -procedohet versioni i ri brenda vitit në mënyrë që Kuvendi të mund ta miratoi këtë ligj brenda këtij viti.

Nurishahe Hulaj-Tha se nga puna që ka bërë Komisioni lidhur me Projektligjin e punës kanë dalë indikatorë shumë të rëndësishëm që ky ligj të kthehet në rishqyrtim. Ajo ishte e pajtimit që të pranohet kërkesa për tërheqje të këtij ligji, por me rekomandimin që Komisioni ta ketë ligjin bazik të definuar qartë. Ajo tha se nuk është e mendimit që Kosova të mbetet pa ligj të punës, por ky ligj të rishqyrtohet dhe të qartësohet-çka përmban ky ligj. Ligji për sigurimet shëndetësore është amendamentuar -definuar, ndërsa Ligji për punën është në procedurë.

Hagji Gashi- Tha se kërkesa e Qeverisë për tërheqje të këtij ligj lehtëson punën e Kuvendit pasi që ky ligj ka nevojë për një ripunim të detajuar.

Rita Hajzeraj-Propozoi të mos tërhiqet Ligji për punën, por të pezullohet shqyrtimi deri në një fazë të caktuar, kur do të procedohet edhe Ligji për shërbyesit civil. Ky propozim nuk u miratua nga anëtarët e Komisionit.

Pas diskutimeve të deputetëve lidhur me propozimin për tërheqjen e Projektligjit të punës, me tetë (8) vota për dhe një (1) abstenim, Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale i

REKOMANDON

- **Kuvendit ta miratojë kërkesën e kryeministrit të Republikës së Kosovës për tërheqjen e Projektligjit për punën nga procedura e shqyrtimit dhe kthimin për ripunim në Qeveri.**
- **Të kërkoj nga Qeveria që në afat sa më të shkurtër ta sjellë Projektligjin e ripunuar në Kuvend .**

Për Ligjin për sigurimet shëndetësore, Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale i

REKOMANDON

Kuvendit ta miratojë kërkesën e kryeministrit të Republikës së Kosovës për tërheqjen e Ligjit për sigurimet shëndetësore nga procedura e shpalljes dhe t'ia kthejë Qeverisë për ripunim.

5. Të ndryshme

Sadik Idriz-Propozoi që Komisioni ta formojë një grup të punës që do ta monitoroi Ligjin për veprimtari private në shëndetësi.

Kryesuesi, konstatoi se Komisioni e nxori këtë

Përfundim

Një grup prej katër anëtarëve do ta bëjë monitorimin e Ligjit për veprimtari private në shëndetësi. Përbërja e këtij grupi është si vijon: Qamile Morina–kryesuese e grupit, Armend Zemaj-anëtar, Mimoza Ahmetaj-anëtare dhe Rita Hajzeraj- anëtare.

Mbledhja përfundoi në orën 11:50

Përgatitur nga

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryesuesi i Komisionit

Sadik Idriz